

UDHËZUES MBI KONTROLLIMIN E SUBSTANCAVE TË RREZIKSHME PËR SHËNDETIN (KSRRSH)

Ky udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave tjerë brenda vendit të punës, që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Ky udhëzues duhet të përdoret si një ndihmë për zhvillimin e sistemeve të sigurta të punës, ndërsa ndërmerren aktivitete me substanca të rrezikshme.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,

Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI	2
CILAT SUBSTANCA JANË TË DËMSHME?	2
SHIKONI ÇDO SUBSTANCË.....	2
TË DHËNAT E SIGURISË	4
PËRMBAJTJA E ETIKETËS	5
LISTAT E KONTROLLUESVE TË RREZIKUT.....	6
VLERËSIMI I RISKUT	Error! Bookmark not defined.
CILAT JANË MASAT E KONTROLLIT TË EKSPOZIMIT?	7
PAJISJET E KONTROLLIT.....	8
MBROJTJA E SHËNDETIT TË PUNËTORËVE	9
AUDITIMET	10
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	10
SHTOJCA	11



HYRJE

Ky udhëzues përshkruan mënyrën se si duhet të kontrollohen substancat e rrezikshme në punë, në mënyrë që ato të mos shkaktojnë lëndime, dëmtim të shëndetit ose të mjedisit. Ky udhëzues do t'ju ndihmojë të kuptoni se si duhet të veproni në pajtim me LIGJIN NR. 04/L-197 (Ligji për Kimikatet), LIGJIN NR. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Udhëzimin Administrativ të MPMS-së -Nr.04/2018 për parandalimin e aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, të cilat aplikohen në mënyrën se si punoni me substanca të rrezikshme.

Çdo vit, mijëra punëtorë sëmurën për shkak të substancave të rrezikshme me sëmundje të tilla si asma, kanceri dhe sëmundje të lëkurës (dermatiti). Këto sëmundje bartin kosto financiare çdo vit në këto grupe:

- Industri, për të zëvendësuar punëtorin e trajnuar;
- Shoqëri, në shtesa për paaftësi dhe ilaçe; dhe
- Individë, të cilët mund të humbin punën e tyre:

Menaxhimi i dobët i substancave të rrezikshme mund të dëmtojë mjedisin, duke krijuar kosto për pastrimin dhe masat e tjera që duhet të ndërmerren pas një incidenti. Punëdhënësit janë përgjegjës për marrjen e masave efektive për të kontrolluar ekspozimin dhe për të mbrojtur shëndetin. Këto masa gjithashtu mund të përmirësojnë prodhimin dhe të zvogëlojnë humbjet.

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky udhëzues përshkruan masat që mund të merren për të menaxhuar dhe zvogëluar rrezikun e ekspozimit ndaj substancave të dëmshme për të zvogëluar rrezikun e lëndimeve, dëmtimit të shëndetit ose të mjedisit.

Ky udhëzues siguron masa që ju, si punëdhënës, duhet të ndërmerrni për të mbrojtur punëtorët tuaj nga substancat e rrezikshme në punë. Ky udhëzues do të jetë gjithashtu i dobishëm për punëtorët, profesionistët e shëndetit dhe sigurisë dhe përfaqësuesit e sigurisë.



CILAT SUBSTANCA JANË TË DËMSHME?

- Ajri me pluhur ose tym mund të shkaktojë sëmundje të mushkërive, p.sh. tek salduesit, gurthyesit, zdrukthëtarët.
- Lëngjet e përpunimit të metaleve mund të rrisin bakteret dhe kërpudhat që shkaktojnë dermatit dhe astmë.
- Lulet, llambat, frutat dhe perimet mund të shkaktojnë dermatit.
- Puna në lagështi, p.sh. hotelieri dhe pastrim, mund të shkaktojë dermatit.
- Kontakti i zgjatur me çimento të lagur në ndërtimtari mund të çojë në djegie kimike dhe/ose dermatit.
- Benzeni në vajin e papërpunuar mund të shkaktojë leukemi.
- Derdhjet p.sh. karburantet mund të dëmtojnë mjedisin, të hyjnë në rrjedhat e ujit dhe të ndotin ujin e pijshëm.

Shumë produkte ose substanca tjera të përdorura në punë mund të jenë të dëmshme, të tilla si bojërat, ngjyrat, ngjitësi, lubrifikantët, detergjenti dhe produktet kozmetike. Dëmtimi i shëndetit i shkaktuar nga këto substanca të përdorura në punë është i parandalueshëm. Shumë substanca mund të dëmtojnë shëndetin, por nëse përdoren siç duhet, ato asnjëherë nuk do të arrijnë të arrijnë një gjë të tillë. .

Substancat gjithashtu mund të kenë veti të tjera të rrezikshme. Ato mund të jenë të ndezshme, për shembull, produktet e bazuara në tretës mund të shkaktojnë avuj të ndezshëm. Retë e pluhurit nga materialet e përditshme, të tilla si pluhuri i drurit, mund të shpërthejnë nëse ndizen.

SHIKONI ÇDO SUBSTANCË

Cilat substanca po përdorim? Në çfarë mënyre janë të dëmshme? Ju mund ta zbuloni duke:

- Kontrolluar informacionin që vjen me produktin, p.sh. një fletë të dhënash të sigurisë;
- Duke pyetur furnizuesin, përfaqësuesin e shitjes ose prodhuesin;
- Duke kërkuar në internet për informacionin mbi shëndetin dhe sigurinë.

Mendoni për detyrën:

Nëse një substancë është e dëmshme, si mund të ekspozohen punëtorët ndaj saj? Ata mund të ekspozohen me anë të:

- Frymëmarrjes në ambiente me gaz, tym, mjegull ose pluhur?
- Kontaktit me lëkurën?
- Gëlltitjes?
- Kontaktit me sy?





- Dëmtimit të lëkurës?
- Gjasave për derdhje dhe dëmtim të mjedisit?

Ekspozimi me frymëmarrje:

Me anë të frymëmarrjes, disa substanca mund të sulmojnë hundën, fytin ose mushkëritë, ndërsa të tjerët futen në trup përmes mushkërive dhe dëmtojnë pjesët e tjera të trupit, p.sh. mëlçinë.

Ekspozimi nga kontakti me lëkurën:

Disa substanca dëmtojnë lëkurën, ndërsa të tjerat kalojnë përmes saj dhe dëmtojnë pjesët e tjera të trupit. Lëkura infektohet:

- Me kontakt të drejtpërdrejtë me substancën, p.sh. nëse e prekni ose zhytni duart në të;
- Me spërkatje;
- Nga substancat që bien në lëkurë, p.sh. pluhuri nga ajri;
- Nga kontakti me sipërfaqet e ndotura - kjo përfshin kontaktin me ndotjen brenda dorezave mbrojtëse.

Ekspozimi me gëlltitje:

Njerëzit i bartin kimikatet nga duart e tyre në gojë duke ngrënë, pirë duhan etj., nëse duart nuk janë pastruar më parë.

Ekspozimi i syve:

Disa lloje të avujve, gazrave dhe pluhurit janë irritues për sytë. Spërkatjet e lëngut kaustik mund të dëmtojnë shikimin përgjithmonë.

Ekspozimi me dëmtim të lëkurës:

Rreziqet nga dëmtimi i lëkurës si në mishtore apo lëndime nga gjilpërat janë të rralla, por mund të shkaktohen infeksione nga substanca shumë të dëmshme, p.sh. duke injektuar ilaçe.





TË DHËNAT E SIGURISË

Produktet që përdorni mund të jenë “të rrezikshme për furnizim”. Nëse është kështu, ato do të kenë një etiketë që ka një ose më shumë simbole rreziku. Disa shembuj janë dhënë më poshtë.

Këto produkte përfshijnë substanca të zakonshme në përdorimin e përditshëm si bojë, zbardhues, tretës ose mbushës. Kur një produkt cilësohet si “i rrezikshëm për furnizim”, me ligj, furnizuesi duhet t'ju ofrojë një fletë mbi të dhënat e sigurisë (FDHS).

FDHS duhet të jetë në dispozicion në vendin e punës.

Shënim: *ilaçet, pesticidet dhe produktet kozmetike kanë legjislacion të ndryshëm dhe mund të mos kenë një fletë të dhënash sigurie. Pyesni furnizuesin se si mund të përdoret produkti në mënyrë të sigurt.*

Fletët mbi të dhënat e sigurisë mund të jenë të vështira për t'u kuptuar, me që përmbajnë informacion të pakët mbi masat e kontrollit. Sidoqoftë, për të mësuar rreth rreziqeve shëndetësore dhe situatave emergjente, përqendrohuni në pjesët që ju tregojnë se cilat janë rreziqet, dhe pjesët që ju tregojnë në lidhje me emergjencat, ruajtjen dhe trajtimin e tyre.

Që nga viti 2009, simbolet e reja ndërkombëtare kanë zëvendësuar gradualisht simbolet Evropiane (shih Figurën 1 dhe 2 më poshtë)

Disa prej tyre janë të ngjashëm me simbolet evropiane, por nuk ka asnjë fjalë të vetme që përshkruan rrezikun.

Lexoni deklaratën e rrezikut në paketim dhe fletën e të dhënave të sigurisë nga furnizuesi.

Figura 1 – Simbolet evropiane



Figura 2 – Simbolet e reja ndërkombëtare





PËRMBAJTJA E ETIKETËS

Një substancë ose përzierje e klasifikuar si e rrezikshme, në paketimin e saj duhet të ketë një etiketë e cila duhet të përmbajë elementet e mëposhtme :

1. Emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit fizik ose juridik që vendos në treg substanca të rrezikshme në Republikën e Kosovës;
2. Sasinë e saktë të substancës ose përzierjes në paketimin që është menduar për përdorim, përveç nëse kjo sasi është specifikuar diku tjetër në paketim;
3. Identifikimin e kimikatit ose produktit;
4. Piktogramet/simbolet e rrezikut;
5. Fjalët e paralajmërimit/sinjalizimit: "Rrezik" ose "Kujdes";
6. Deklaratën/shprehjet e rrezikut të tilla si: "Zjarr", "Rrezik i përgjithshëm", "Vdekjeprurës nëse gëlltitet" etj.;
7. Deklarata përkatëse;
8. Një pjesë për informacion shtesë.





LISTAT E KONTROLLUESVE TË RREZIKUT

Përdorimi i një liste kontrolluese është thelbësore për të përcaktuar se cilat masa kontrolli do të kërkohen kur përdorni substanca të rrezikshme.

- A ka produkti që përdorni një etiketë mbi rrezikun që bartë?
- A prodhon veprimtaria juaj gaz, tym, pluhur, mjegull apo avull?
- A është substanca e dëmshme për frymëmarrje?
- A mund të dëmtojë substanca lëkurën tuaj?
- A ka gjasa që dëmtimi mund të paraqitet për shkak të mënyrës se si e përdorni ose prodhoni atë?
- Çfarë do të bëni në lidhje me këtë?
- A do të përdorni diçka tjetër?
- A do ta përdorni atë në një mënyrë tjetër, më të sigurt?
- A do ta kontrolloni atë për ta parandaluar dëmtimin?

VLERËSIMI I RISKUT

Vlerësimi i riskut është element themelor për të punuar në mënyrë të sigurt me substanca të rrezikshme. Bëhet fjalë për ndërmarrjen e hapave të arsyeshëm për të parandaluar lëndimet, dëmtimin e shëndetit dhe mjedisit. Ju duhet ta kuptoni mënyrën se si punëtorët dhe të tjerët, kanë rënë në kontakt me substancën e rrezikshme, dhe për sa kohë janë ekspozuar me atë substancë, para se të vendosni nëse duhet të ndërmerri ndonjë hap për të zvogëluar ekspozimin.

Punëdhënësit duhet të vlerësojnë rrezikun për punëtorët e tyre (dhe të tjerët që mund të preken), për të parandaluar ose kontrolluar në mënyrë adekuate ato rreziqe. Gjithmonë ndiqni hierarkinë e kontrollit kur kryeni një vlerësim të rrezikut.

Zgjedhja e masave të kontrollit (sipas rendit të përparësisë):

1. Eliminoni/zëvendësoni/reduktoni përdorimin e një produkti ose lënde të dëmshme dhe përdorni një më të sigurt.
2. Përdorni një formë më të sigurt të produktit, p.sh. pastë e jo pluhur.
3. Ndryshoni procesin e punës për të liruar më pak substanca.
4. Mbyllni procesin e punës në mënyrë që produkti të mos lirohet.
5. Nxirrni emetimet e substancës afër burimit.
6. Angazhoni sa më pak punëtorë që është e mundur në detyrat me rrezik.
7. Siguroni pajisje mbrojtëse personale (PMP) të tilla si doreza, kominoshe dhe një aparat respirator. PMP-të duhet të përshtaten sipas përdoruesit.



CILAT JANË MASAT E KONTROLLIT TË EKSPOZIMIT?

Masat e kontrollit janë një përzierje e pajisjeve dhe mënyrave të punës për të zvogëluar ekspozimin. Kombinimi i duhur është thelbësor. Asnjë masë, sado praktike qoftë ajo, nuk mund të funksionojë nëse nuk përdoret si duhet. Çdo “sistem i sigurt i punës” duhet të kombinojë pajisjet e duhura me mënyrën e duhur të punës. Kjo nënkupton udhëzimin, trajnimin dhe mbikqyrjen e punëtorëve që kryejnë detyrat e tilla. Masat e kontrollit janë të nevojshme për çdo punë që vazhdon pa ndërprerë - gjithë ditën dhe çdo ditë.

Shembuj të masave të kontrollit mund të përfshijnë:

Substanca, përpunim	Kontrolli i pajisjeve	Mënyra e punës	Menaxhimi
<ul style="list-style-type: none">• Pastrimi me tretës në leckë.	<ul style="list-style-type: none">• Përdorni mbajtëse leckash.• Siguroni një shportë të vogël me një kapak për leckat e përdorura.	<ul style="list-style-type: none">• Shmangni kontaktin me lëkurën.• Reduktoni avullimin e tretësit nga leckat e përdorura.	<ul style="list-style-type: none">• Kontrollat kryhen.• Asgjësim i sigurt.
<ul style="list-style-type: none">• Pluhur dhe shkëndija nga disku gërryes.	<ul style="list-style-type: none">• Vendosni një mbyllje rreth diskut dhe nxirrni ajrin në një vend të sigurt.	<ul style="list-style-type: none">• Kontrolloni treguesin e qarkullimit të ajrit.• Sigurohuni që nxjerrja funksionon.	<ul style="list-style-type: none">• Mbani kontrollet.• Testoni kontrollet siç kërkohet me ligj.
<ul style="list-style-type: none">• Avulli nga prerja e mbetjeve metalike.	<ul style="list-style-type: none">• Helmeta saldimit me ventilim, doreza.• Pastrimi i objekteve.	<ul style="list-style-type: none">• Punoni në ambientet e jashtme kurdo që është e mundur.• Lëreni tymin të pastrohet para se të hiqni helmeten.	<ul style="list-style-type: none">• Kontrolloni nëse ka ndonjë bojë plumbi në copëzat që priten.• Kryeni kontrolle shëndetësore nëse kërkohet nga ligji
<ul style="list-style-type: none">• Mjegulla e lëngut prerës nga një torno.• Produkti nga tornoja.	<ul style="list-style-type: none">• Vendosni një mbyllje rreth tornos dhe nxirrni ajrin në një vend të sigurt.• Doreza mbrojtëse.	<ul style="list-style-type: none">• Përdorni produkte për kujdesin ndaj lëkurës.• Sigurohuni që nxjerrja funksionon.• Prisni deri sa mjegulla të pastrohet nga mbyllja përpara se ta hapni.	<ul style="list-style-type: none">• Trajnoni punëtorët.• Kontrolloni dhe mbani cilësinë e lëngut.• Testoni kontrollet siç kërkohet me ligj.• Kryeni kontrolle shëndetësore nëse kërkohet nga ligji
<ul style="list-style-type: none">• Pluhur nga prerësi i diskut në tavolinë të gurit.	<ul style="list-style-type: none">• Përdorni një mbyllje për të nxjerrë ajrin në një vend të sigurt.• Përdorni fshesë elektrike me efikasitet të lartë.	<ul style="list-style-type: none">• Preni dhe lustroni gurin brenda mbylljes.• Fshijeni pluhurin me fshesë elektike.	<ul style="list-style-type: none">• Testoni dhe mbani kontrollet.• Kryeni kontrolle shëndetësore nëse kërkohet nga ligji



PAJISJET E KONTROLLIT

Pajisjet e kontrollit vijnë në shumë forma. Ato përfshijnë ventilimin për nxjerrje të pluhurit, mjegullës dhe tymit, kuti dorezash dhe ventilues tymi, si dhe hapësira me spërkatje (dhoma të pastra në zona të ndotura të punës). Ato gjithashtu përfshin përdorimin e ujit për të reduktuar pluhurin dhe sistemet për dezinfektimin e ujit për ftohje.

Furnizuesi juaj duhet të sigurojë një manual përdorimi për “pajisjet e kontrollit”. Nëse nuk keni, kërkoni atë. Dhe nëse kjo është e pamundur, mund t'ju duhet ndihmë profesionale për të shkruar një të tillë. Manuali i përdorimit duhet të përcaktojë oraret për kontrollet, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e pjesëve.

Për shembull, manuali i përdorimit duhet të përfshijë:

- Një përshkrim të sistemit;
- Kontrollet ditore që punëtori ose mbikëqyrësi duhet të kryejnë, p.sh. aktivizimi i ventilimit, treguesi i rrjedhës së ajrit jep leximin e duhur;
- Mbikëqyrësi ose pronari duhet të kryejnë kontrolle javore ose mujore që, p.sh. vjetrimin dhe dëmtimin e pajisjeve, nëse qarqet e shkurtra nuk po krijojnë rreziqe;
- Detajet e çdo ekzaminimi dhe testi të plotë;
- Shenjat e vjetrimit dhe dështimit të kontrollit;
- Një listë të pjesëve rezervë;
- Një përshkrim se si operatorët duhet ta përdorin sistemin në mënyrë që ai të funksionojë në mënyrë efektive.

Mbajtja e kontrollit, kontrollimi dhe mirëmbajtja:

Pasi të keni marrë kontrollin, duhet ta mbani atë. Si punëdhënës, duhet të siguroheni që masat e kontrollit (pajisjet dhe mënyra e punës) të vazhdojnë të punojnë ashtu siç duhet.

Ju duhet të emëroni dikë që të jetë përgjegjës për kontrollimin dhe mirëmbajtjen e masave të kontrollit. Mund të jeni ju, ose dikush që emëroni, për sa kohë që ata e dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe janë në gjendje ta bëjnë atë. Kjo nënkupton që ata janë “të aftë” të :

- Kontrollonjë që procesi nuk po liron ndotës të pakontrolluar;
- Kontrollonjë që pajisjet e kontrollit vazhdojnë të punojnë ashtu siç janë dizajnuar;
- Kontrollonjë që punëtorët janë duke ndjekur mënyrën e duhur të punës.



Dy nga masat më të zakonshme të kontrollit ku mirëmbajtja është vendimtare janë ventilimi lokal i shkarkimit (VLSH) dhe pajisjet mbrojtëse personale (PMP). Nëse përdorni ventilim lokal të shkarkimit për të kontrolluar ekspozimin, ai ka nevojë për kontroll dhe mirëmbajtje të rregullt.


Pajisjet mbrojtëse personale shpesh përdoren si pjesë e masave të kontrollit. Kjo gjithashtu ka nevojë për kontroll dhe mirëmbajtje sepse, nëse dështon, nuk siguron më mbrojtje dhe e vë bartësin para rrezikut. Përdoruesit dhe gjithashtu edhe mbikëqyrësit, duhet të dinë saktësisht se çfarë po bëjnë.

Lista kontrolluese për praktikën e mirë të kontrollit:

- A i dizajnoni dhe drejtoni proceset tuaja në atë mënyrë që përhapja e ndotësve të jetë sa më të ulët që të jetë e mundur?
- A mendoni për të gjitha mënyrat e ekspozimit - frymëmarrjen, lëkurën ose gëlltitjen?
- A i zgjidhni masat e kontrollit sipas sasisë së substancës, si futet në trup dhe sa dëm mund të shkaktojë?
- A siguroheni që masat janë efektive, të lehta për t'u përdorur dhe që funksionojnë si duhet?
- A duhet të jepni edhe pajisje mbrojtëse personale (PMP)?
- A kontrolloni rregullisht që masat vazhdojnë të funksionojnë dhe a mbani shënime?
- A u tregoni punëtorëve për rreziqet dhe si të përdorin masat e kontrollit siç duhet?
- A i shmangeni rritjes së rreziqeve të përgjithshme të shëndetit dhe sigurisë kur bëni ndryshime?
- A mbani një listë të inventarit të substancave të identifikuar që janë të rrezikshme?
- A janë procedurat e punës, mbikëqyrja dhe trajnimi sipas FDHS-së dhe/ose sipas autorizimit të kompanisë për artikujt e identifikuar?
- A janë kontejnerët, depoja, përdorimi, transferimi i substancave të rrezikshme sipas FDHS-së dhe/ose sipas vlerësimit të rrezikut?
- A i vini në dispozicion pajisjet e zbulimit dhe monitorimit sipas vlerësimit të rrezikut?

MBROJTJA E SHËNDETIT TË PUNËTORËVE

Është thelbësore që të ruhet shëndeti i punëtorëve dhe të tjerëve që mund të preken nga substancat e rrezikshme. Kjo mund të jetë aq e thjeshtë sa mund të bëhet me anë të kontrolleve të rregullta të lëkurës për të shikuar nëse ka shenja të dermatitit si dhe të kryhen kontrole më të hollësishme mjekësore nga Profesionistët e Shëndetit në Punë, të cilët kontrollojnë funksionin e mushkërive, shikimin dhe dëgjimin etj.





AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar të Shtojcës. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Mbani mend: Kontrolli i substancave të rrezikshme për shëndetin është thelbësor për parandalimin e sëmundjeve dhe dëmtimeve në vendin e punës. Përdorni këtë Udhëzues për të ndihmuar zhvillimin e sistemeve të sigurt të punës, ndërsa ndërmerrni aktivitete me substanca të rrezikshme

Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.



SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për "Kontrollin e Substancave të Rrezikshme për Shëndetin" (Udhëzuesi), siç është marrë nga dokumenti i listës së kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së i BE-së i zhvilluar në mars të vitit 2021, janë paraqitur si më poshtë:

Seksionet referuese:

2.2.1 Agjentët kimik

1. A etiketohen qartë kimikatet (a përmbajnë etiketat emrin e substancës kimike ose emrin tregtar të përzjerjes, piktogram(ët) e rrezikshme, deklaratat e rrezikut dhe të sigurisë)? Nëse kimikatet janë etiketuar si të rrezikshme, a janë piktogramët në etiketa në përputhje me legjislacionin?)
2. A janë qartë të dukshme etiketat në kontejnerët e kimikateve të përdorura për punë ose depozitim?
3. A janë kimikatet në kontejnerë të përshtatshëm (shishe, kova, etj.) për përdorimin dhe ruajtjen e tyre?
4. A ka kimikate që nuk mund t'i identifikoni?
5. A është proporcionale sasia e kimikateve të pranishme në vendin e punës me sasinë e substancave të nevojshme për të kryer detyrën gjatë një dite?
6. A ruhen kimikatet e rrezikshme në ambiente të ftohta, të ajrosura mirë? A merret parasysh kompatibiliteti i mallrave të rrezikshëm gjatë magazinimit? Nëse ka lëngje të ndezshme, a janë ata larg burimeve të ndezjes?
7. A janë lehtë të lexueshme shenjat paralajmëruese në zona të rrezikshme?
8. A mbliidhet dhe hiqet sistematikisht paketimi i zbrazët i kimikateve të përdorura nga vendet e punës?
9. A janë të disponueshme Fletët e të Dhënave të Sigurisë (FDP) dhe a munden punonjësit t'i qasen lehtë atyre?
10. A janë siguruar pajisjet dhe mjetet e nevojshme për përdorim të sigurt të kimikateve (p.sh. ventilimi, pompat, mjetet për mbledhjen e derdhjeve dhe rrjedhjet e kimikateve)?
11. A janë të punësuarit të pajisur me PMP adekuate dhe të përshtatshme?
12. A janë të shënuara nënshkruara qartë zonat/detyrat e përcaktuara për përdorimin e PMP-ve?
13. A janë punonjësit të informuar/trajnuar pse duhet të përdorin PMP-të?
14. A janë në dispozicion dhe të shënuara objektet e ndihmës së parë?
15. A përfshihet vlerësimi i riskut nga substancat kimike dhe përzjerjet e përdorura në vlerësimin e rrezikut në vendin e punës?
16. A merren parasysh informacionet e disponueshme nga FDP për substancat kimike dhe përzjerjet në vlerësimin e rrezikut në vendin e punës? A përfshihet informacioni mbi përdorimin e sigurt të kimikateve të dhëna në FDP në udhëzimin për mbrojtjen në punë?
17. A merren masa për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet kimike? A keni vlerësuar nëse rreziqet mund të shmangen ose zvogëlohen mjaftueshëm me mjete teknike të mbrojtjes kolektive ose me masa, metoda ose procedura të organizimit të punës?



18. A janë vendosur shenjat e sigurisë (shenja paralajmëruese, shenja të detyrueshme) në përputhje me vlerësimin e rrezikut në vendin e punës?
19. A përfshijnë shënimet e trajnimit efektet në shëndet, kontrollet, metodat e sigurta të punës dhe pajisjet/veshjet mbrojtëse personale?
20. A janë trajnuar punonjësit për rreziqet e trajtimit dhe përdorimit të kimikateve dhe përzierjeve?
21. A janë kryer matjet e kimikateve në ajrin në vendin e punës? A janë krahasuar rezultatet e matjes me vlerat kufitare të ekspozimit gjatë punës?
22. A janë identifikuar agjentë kimikë të rrezikshëm në vlerësimin e rrezikut që mund të ketë lidhje me një sëmundje të identifikueshme ose efekt të pafavorshëm shëndetësor?
23. Nëse vlerësimi i riskut përcakton që kimikatet mund të kenë ndikim në shëndet, a janë dërguar punonjësit në kontrollet e detyrueshme shëndetësore?